



Numri i lëndës: KSC-CA-2023-02/R

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 janar 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm

Gjykatësit të Vetëm:

Gjykatës Zhilber Biti

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Salih Mustafës:

Venkatesvari Alagendra

Mbrojtjes së Viktimave:

Ani Puz

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të 22(8), 33(2) dhe 44(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), cakton Gjykatësin e Vetëm për shqyrtimin e Versionit të Redaktuar Publik të Urdhrit për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës me katër Shtojca rreptësisht konfidenciale dhe *Ex Parte* (“Urdhri për Zhdëmtim” ose “Urdhri”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses I lëshoi Aktgjykimin ku, ndër të tjera, e shpalli z. Salih Mustafa fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e shpalli të pafajshëm për krimin e luftës të trajtimit mizor.² Trupi Gjykses e dënoi z. Mustafa me 26 vjet burgim.³

2. Më 6 prill 2023, Trupi Gjykses I lëshoi Urdhrin për Zhdëmtim, ku, ndër të tjera, ftonte Kryetaren të “caktojë një autoritet gjyqësor që do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të këtij Urdhri për Zhdëmtim”.⁴

3. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi Aktgjykimin e Apelit me të cilin la në fuqi vendimet e fajësisë së z. Mustafa për krimet e luftës të ndalimit arbitrar,

¹ KSC-BC-2020-05/F000517/RED, Version i Redaktuar Publik i Urdhrit për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës, me 4 Shtojca rreptësisht konfidenciale dhe *Ex Parte*, 6 prill 2023. Versioni i korrigjuar i versionit të redaktuar publik të Urdhrit për Zhdëmtim u dorëzua më 14 prill 2023, KSC-BC-2020-05/F00517/RED/COR, para. 252-253.

² KSC-BC-2020-05/F00494, Aktgjykim, 16 dhjetor 2022 (konfidencial), para. 831. Versioni i redaktuar publik i Aktgjykimit u dorëzua më 8 qershor 2023 dhe versionet e korrigjuara të versionit të redaktuar publik të Aktgjykimit u dorëzuan, përfshirë më 24 janar 2023.

³ Aktgjykimi, para. 831.

⁴ *Shih* Urdhrin për Zhdëmtim, para. 283(j).

torturës dhe vrasjes së paligjshme.⁵ Paneli i Gjykatës së Apelit miratoi pjesërisht apelin e z. Mustafa kundër dënimit. dhe e uli në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.⁶

III. CAKTIMI

4. Siç deklaroi Trupi Gjykses I, “juridiksioni i tij në këtë çështje gjyqësore [...] përfundoi pas lëshimit të Urdhrit për Zhdëmtim, në pajtim me nenin 33(1)(b) të Ligjit”.⁷ Meqenëse korniza ligjore e Dhomave të Specializuara nuk parasheh ndonjë “autoritet gjyqësor”, atëherë do të caktohet një gjykatës i vetëm në pajtim me nenin 33(2) të Ligjit duke mbajtur parasysh rrethanat konkrete të kësaj çështje gjyqësore. Gjykatësi i Vetëm do të caktohet të mbikëqyrë zbatimin e Urdhrit të Zhdëmtimit nga Administratorja siç përcaktohet në paragrafët 255-257, 259, 269, dhe 283(f) të Urdhrit si dhe të marrë raporte nga Administratorja lidhur me çdo masë të marrë në kuadër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

5. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, detyrat e ushtruara si gjykatës raportues, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA CAKTON:

Gjykatësin Zhilber Biti

si Gjykatës të Vetëm për qëllimet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij vendimi, për një periudhë njëvjeçare nga lëshimi i këtij vendimi.

⁵ F00038, Aktgjykimi i Apelit, 14 dhjetor 2023, para. 484. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë.

⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 484.

⁷ *Shih* Urdhrin për Zhdëmtim, para. 250.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E mërkurë, 17 janar 2024

Në Hagë,

Holandë